

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"U bë gjysh katër herë", djali i Jakup Krasniqit flet nga Haga: Nesër presim pafajësi - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/verdikti-per-ish-drejtuesit-e-uck-se-djali-i-jakup-krasniqit-presim-qe-te-katert-te-jene-te-lire/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 20:00:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 19:54:30 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	35d3c0c7c9bb139e9cf69cbb6798c415ef6f38cea0b4d61e8e20aa14046286bb
TEKSTI	f0b6c8198d00f1b3f6a1b4c5e1cf644106d813fb81b75a84f72d7f7069bbbfa2
PAMJA	a605a1c91085c4519ec7e428169e1cf1de81b003876f74ef786b999f7d98b10b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	296f79813b4d9e726acb02021a225d9687fcd3ec410dc72c1fade52aff00bd4a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9dbe3bb033f14c903d871b5f44056dbb0c7543241b7df3ea5dc415a83f1a9da2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/296f79813b4d9e726acb02021a225d9687fcd3ec410dc72c1fade52aff00bd4a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Kosova Erion Veliaj Donald Trump Rusia Inteligjenca Artificiale

KOSOVË | LAJM KRYESOR

“U bë gjysh katër herë”, djali i Jakup Krasniqit flet nga Haga: Nesër presim pafajësi



15 Shtator 2026 | 21:54

Në një lidhje nga Haga për emisionin “Now me Erla Mëhillin”, gazetarja e Euronews, Esmeralda Mualaj, mori një intervistë me djalin e Jakup Krasniqit, Altin Krasniqi.

Altin Krasniqi tha se familja po i përjeton me stres këto orë pritjeje, ndërsa shprehu shpresën se nesër babai i tij dhe ish-drejtuesit e tjerë të UÇK-së do të shpallen të pafajshëm. Ai e cilësoi procesin gjyqësor si më shumë politik sesa të drejtë dhe tha se, sipas tij, nuk ka pasur prova apo dëshmi që inkriminojnë luftën e UÇK-së.

Ai foli edhe për vitet e gjata të mungesës së babait në familje, duke treguar se Jakup Krasniqi është bërë gjysh katër herë gjatë kësaj periudhe dhe se nuk ka mundur të përjetojë momente të rëndësishme. Megjithatë, Altin Krasniqi theksoi se ndihet krenar për kontributin e të atit në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, pavarësisht vendimit që do të merret.

“Janë pak stresuese këto orë pritjeje. I ka ardhur fundi, jemi duke pritur të lirohet. Shpresa jonë është që atë ta shpallin të pafajshëm. Këto gjashtë vite, procesi ka qenë më shumë politik sesa se ka pasur drejtësi. Kushdo që e ka përcjellë e ka parë se s’ka as prova apo dëshmi që inkriminojnë luftën e UÇK-së. Kemi pritur që të mos zgjaste kaq shumë, që të kishte një proces të drejtë dhe me standarde evropiane dhe që provat që merren të jenë kredibile dhe jo të marra nga Serbia. Kështu që mendoj që procesi u inkriminua që prej fillimit dhe presim që në fund të ketë drejtësi. Ne besojmë që, në fund, kur të merret aktgjykimi për secilën pikë të aktakuzës, duhet të ketë një arsyetim pse dhe nuk besoj se për asnjërën pikë nuk kanë një arsye pse duhet të dënohen. Prandaj, unë besoj se në fund do të jetë proces drejtësie dhe jo vendim politik. Gjatë këtyre viteve që babai ka qenë larg, kemi pasur momente gëzimesh dhe hidhërimesh. Kur kemi pasur të afërm që kanë humbur jetën, kemi pasur edhe gëzime. Ai u bë gjysh katër herë, ka tre mbesa dhe një nip, por s’ka mundur ta shijojë pleqërinë. Ashtu siç nuk e ka shijuar as rininë, pasi ka vuajtur rreth 10 vjet burg gjatë viteve ’80 deri në ’91. Kështu që për ne ka qenë pak e rëndë çështja e moshës, por pavarësisht gjithçkaje dhe dhimbjes, për mua është krenari e madhe që ai ka qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Jam krenar për kontributin e tij, pavarësisht se çfarë vendimi merret nesër. Emrat e fëmijëve i kemi vendosur me bashkëshorten, por sigurisht të frymëzuar nga babai, i cili gjithmonë na ka dhënë atdheadashurinë për Shqipërinë. Ne e duam njëjtë si Kosovën, ashtu edhe Shqipërinë. Babai, gjatë këtyre gjashtë viteve, na ka thënë që duhet të qëndrojmë të fortë, të mos ndalim proceset e jetës, të vazhdojmë të jemi të fortë dhe të arrijmë qëllimet në jetë. Secili prej fëmijëve ka pasur

LAJMI I FUNDIT

21:31 Gazetari tregon çfarë pritët pas vendimit të Gjykatës së Lartë: Ky ishte treni i fundit për Veliajn

21:24 “Nuk prisja që Veliaj të dilte nga burgu”, Iljazaj: Ka ndjekur një strategji të gabuar

21:13 “Ndoshta do të të vrasin”, batuta e Trump për kryeministrin kanadez pasi i dhuroi një çelës për në Shtëpinë e Bardhë

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

20:59 BE masa të reja për të lehtësuar lëvizshmërinë e punëtorëve

20:52 Arabia Saudite zvogëlon eksportet e naftës në Evropë pas sulmit në tubacion

20:47 “Më mbështesni ose jap dorëheqjen”, Merz “ultimatum” CDU-së pas rezultateve negative

TESTIM

mbështetjen e tij dhe ai ka qenë më i fortë se ne. Angazhimi i babait në politikë e ka emocionuar shumë dhe gjithmonë na ka thënë: 'Kur të bëj 70 vjet, do ta lë politikën dhe do t'i përkushtohem familjes'. Dhe dy muaj para se të bënte 70 vjet, e morën. Normalisht, nëna i ka ato emocionet, se ka dashur ta kalojë pleqërinë me të. Pas vuajtjeve që ka kaluar babai, ishte më se e drejtë që të mos ndodhte kjo. Nesër presim lajme të mira, jemi optimistë, besojmë në drejtësi. Besojmë që, nëse bazohen në fakte dhe dëshmi, të katërt do të jenë të lirë", tha ai.

Verdikti për ish-drejtuesit e UÇK-së, gazetarja e Euronews nga Haga: Thaçi do ngrihet i pari në këmbë

Shiko në:

| LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | KOSOVË

"Policia masa për të ndaluar grumbullimet para gjykatës", gazetarja e Euronews raporton nga Haga

Qytetarë shqiptarë nga Kosova, Shqipëria, vende të ndryshme të Evropës, si dhe nga diaspora më e gjerë, janë mbledhur në Hagë në pritje të vendimit...

20:15 | 15/09/2026

KOSOVË

Djali i Jakup Krasniqit tregon mesazhin që ia dha i ati, ja çfarë i tha

Kur kanë mbetur më pak se 15 orë deri në shpalljen e vendimit të shkallës së parë të Gjykatës Speciale për ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare...

19:55 | 15/09/2026

EURONEWS TONIGHT ME MIRELA MILORI | KOSOVË | LAJMI
KRYESOR | LAJMI I FUNDIT | RAJONI

Verdikti për ish-drejtuesit e UÇK-së, gazetarja e Euronews nga Haga: Thaçi do ngrihet i pari në këmbë

Gazetarja e Euronews Albania, Esmeralda Mulaj, raportoi nga Haga se qytetarë shqiptarë nga Kosova, Shqipëria dhe vende të ndryshme të Evropës e më gjerë janë...

19:46 | 15/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Follow Euronews on all platforms: